



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.2010/6 prot.

Tiranë më 21.7.2023

REKOMANDIM

Nr. 35, datë 21.7.2023

PËR KONTROLLUESIN “ADRIA FERRIES AGENCY SH.P.K.”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Adria Ferries Agency SH.P.K.” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 99, datë 30.06.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga subjekti i të dhënave B.A, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NUIS L42311503A, i cili ushtron aktivitetin e shërbimeve si agjenci detare dhe të rekomandimeve detare si: broker detar, ajror dhe siguracionesh; shërbime detare dhe ajrore; shërbime të transportit dhe të ngjashme me të; aktivitetet në veprimet portuale; asistencë dhe organizim i operacioneve të ngarkim/shkarkimit të mallrave dhe

pasagjerëve; veprimtari eksporti dhe importi i mallrave në përgjithësi dhe veprimtari turistike dhe tour operator.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë, “vizitorë”, “nëpunës”, “klientë”. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Pranë Zyrës së Komisionerit është paraqitur një ankesë, përmes së cilës ankuesi ngre pretendime në lidhje me një përhapje të paligjshme të të dhënave personale të pasagjerëve. Përhapja e të dhënave personale konsiston në një dokument të printuar në përmbajtje të të cilit ndodhet një tabelë me listën e pasagjerëve dhe që përmban kategoritë e të dhënave: “emër”, “mbiemër”, “gjinia”, “shtetësia”, “datëlindja”, “vendbanimi”, “Nr. ID”, “kodi i udhëtimit”, “data e udhëtimit” dhe “trageti”. Dokumenti përmban të dhëna të përmbledhura për pasagjerët e dy linjave të transportit detar Adria Ferries dhe GNV.

Nga verifikimi rezulton se, Kontrolluesi ka lidhur Kontratë më datë 01.12.2021, për përfaqësimin detar për mallra dhe pasagjerë, me përfaqësuesin ligjor Frittelli Maritime Group S.P.A, të “Adria Ferries S.P.A”, me seli në Ankona, Itali.

Konstatohet se, Kontrolluesi, ndër të tjera, gjatë ushtrimit të aktivitetit për shitjen e biletave përdor sistemin “*Booking vers.2021*” të ofruar nga “Adria Ferries S.P.A”. Të dhënat që mblidhen nga ky sistem janë: “Emër”, “Mbiemër”, “Gjinia” “Data e Lindjes”, “Nr. ID”, “Shtetësia”, “të dhënat e mjetit”, “akomodimi”. Shërbimet e mirëmbajtjes dhe zhvillimit të sistemit, ku përfshihen dhe modulet informatike respektive të “*Biletave*”, kryhen nga kompania “*mëmë*” në Itali.

Kontrolluesi gjeneron të dhënat në formatin “.pdf” nga sistemi elektronik, dhe këto të dhëna i dërgon nëpërmjet postës elektronike drejt: Autoritetit të Policisë së Kufirit, Portit të Barit, Guardia di Finanza, Agjencisë Detare në Bari, Kapitenerisë së Portit të Barit, Guardia Costiera, Policisë Kufitare të Durrësit, Doganës së Durrësit, Kapitenerisë së Durrësit, Autoritetit Portual të Durrësit, Autoriteti Kombëtar të Ushqimit, Frittelli Maritime Group, Adria Ferries S.p.A, si dhe anijes së udhëtimit.

Nga verifikimi në vend i pretendimit të ankuesit rezulton se, Kontrolluesi është përgjegjës vetëm për klientët që pajisen me biletë udhëtimi, në cilësinë e pasagjerit. Të dhënat e pasagjerëve që mbledh dhe përpunon Kontrolluesi, dërgohen tek autoritet përkatëse, si dhe tek palë të treta në zbatim të kontratës respektive. Gjithashtu, nga verifikimi i të dhënave në sistemin elektronik “*Booking vers.2021*”, rezultoi se nuk ka të dhëna mbi subjektet e të dhënave, të vendosur në dispozicion nga provat e ankuesit.

3. Kontrolluesi për shitjen e biletave operon në të gjithë territorin e Shqipërisë nëpërmjet agentëve/brokerave. Rezulton se, me kërkesë të Kontrolluesit pranë kompanisë

“mëmë” krijohet dhe administrohet në sistemin elektronik “*Booking vers.2021*” çdo llogari e agjentëve që operojnë në Shqipëri.

Nga verifikimi, në vend, i sistemit “*Booking vers.2021*”, rezulton se, ndër të tjera, të dhënat personale për personat të cilët kanë rezervuar një biletë udhëtimi, ruhen pa afat, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale të parashikuara në germen “d” të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me të dhënat personale të grumbulluara gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Kontrolluesi duhet të parashikojë ruajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër sesa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin e grumbullimit. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e grumbullimit të informacionit.

4. Grupi i Kontrollit konstaton se, Kontrolluesi ka të instaluar sistemin e video-survejjimit (CCTV), të përbërë nga 4 kamera, i cili kryen mbikëqyrjen e ambienteve të korridorit, por nuk ka vendosur tabelën e informimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*” i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 3*”).

Gjithashtu, gjatë ofrimit të shërbimit, pajisja me biletë udhëtimi për subjektet e të dhënave, Kontrolluesi vendos në dispozicion të pasagjerëve një Formular në gjuhën italiane të quajtur “*Informativa sul trattamento del dati personali ex art. 13 eu 2016/679*”, në të cilën informohen subjektet e të dhënave për përpunimin e të dhënave sipas një legjislacioni të huaj, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale, të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja, sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Kur mbledh të dhëna personale, Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij, etj.

5. Nga shqyrtimi i kontratës të sipërcituar me “*Adria Ferries S.p.A*”, rezulton se nuk janë parashikuar detyrimet midis palëve, sipas legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërsa, sa i përket parashikimeve të gremës G, të nenit 5, të kësaj kontrate, rezulton se detyrimet janë të përgjithshme dhe nuk i përmbahen parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në*

rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).

Gjithashtu, konstatohet se Kontrolluesi, gjatë ushtrimit të aktivitetit lidh kontrata me palë të treta, të tipit agent/broker, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë për shitjen e biletave të udhëtimit në emër të Kontrolluesit.

Konkretisht, Kontrolluesi ka lidhur kontratë me objekt *“Kontratë për autorizimin e shitjes së biletave të Kompanisë së Lundrimit Adria Ferries S.p.A”* me Agjencinë *“Megi Travel”*. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së kësaj kontrate rezulton se detyrimet e përcaktuara nuk janë sipas legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale dhe nuk i përmbahen parashikimeve të nenit 20 të Ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës, të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave tek përpunuesit, të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sipas përcaktimeve të Udhëzimit të sipërcituar, çdo kontratë përpunimi (outsourcing), që ka për qëllim përpunimin e të dhënave personale, duhet të përmbajë dispozita konkrete që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit shqiptar. Çdo kontratë e tillë, duhet të parashikojë çdo masë që merr përpunuesi për të siguruar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave.

6. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, si dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit rezulton se, Kontrolluesi nuk ka *“Njoftuar”* mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në kundërshtim me parashikimet e nenit 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për *“Njoftim”* mbi përpunimin e të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

7. Kontrolluesi nuk disponon *“Rregullore për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një Rregullore specifike “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Gjithashtu, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

8. Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit “*Deklaratën e Konfidencialitetit*”, në përmbushje të detyrimit ligjor që buron nga neni 28 i Ligjit, si dhe akti nënligjor, Vendimi nr. 6, datë 05.08.2013 i Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*” (në vijim, “*Vendimi nr. 6*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se qëllimi i nënshkrimit të “*Deklaratës së Konfidencialitetit*” është që, të gjithë punonjësit, të cilët kanë akses në të dhëna personale, të kuptojnë qartë dhe drejtë, detyrimet që ata kanë mbi përpunimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit. Në aktin formal me titull “*Deklaratë Konfidencialiteti*”, dalë në zbatim të Vendimit nr. 6 të Komisionerit, punëmarrësit informohen mbi përgjegjësitë, në rast përhapje në mënyrë abuzive të të dhënave personale tek personat e paautorizuar.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit janë paraqitur në seancën dëgjimore, datë 19.07.2023, të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe kanë pranuar konstatimet e grupit të kontrollit, si dhe kanë deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 18, 20, 21, 27, 28, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale;
3. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
4. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të “Njoftojë” Zyrën e Komisionerit, për gjendjen e njoftimit të përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të hartojë Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, e cila duhet të përmbajë masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi që kryen, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj;
6. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në nenin 27 të Ligjit, lidhur me trajnimin e stafit të tij;
7. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të hartojë dhe aplikojë për punëmarrësit “Deklaratën e Konfidencialitetit”;
8. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:

- (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguar në pikat 1, 2, 4 dhe 7 më sipër;
- (ii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguar në pikat 3 dhe 5 më sipër;
- (iii) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 6 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

9. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;

10. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 21.7.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi